

Filozofi i njohur dhe linguisti, Noam Chomsky, në një intervistë me Abby Martin, pushtimin e Irakut nga SHBA-ja në vitin 2003 e ka quajtur "krimi më i rëndë i këtij shekulli".

"Ka patur efekte të tmerrshme; ka ndezur konflikte sektare që tani po e ndajnë regjionin. Vet ideja e pushtimit është kriminale. Proveni ta gjeni dikë që e quan këtë vepër kriminale. Obama e quan gabim, por a quan ai këtë krim, apo dikush tjetër?", ka pyetur intelektual i kalibrit botëror Chomsky, transmeton Indeksonline.

Obama, presidenti i 44-të i SHBA-ve, kishte garuar me një program anti-luftë, ndërsa për këtë kishte marrë edhe çmimin Nobel për Paqe në vitin 2009, duke premtuar reduktimin e forcave amerikane në Lindjen e Mesme.

"Përkundrazi, Obama po e drejton një program terrori global që nuk është parë asnjëherë më parë", ka konkluduar Chomsky duke iu referuar programit me dronë që zbaton SHBA-ja.